

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

Raporti Përfundimtar “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e aktivitetit 01.01.2011-30.06.2013, kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, Tiranë është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 157 datë 20.12.2013. Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 704/8 prot., datë 23.12.2013 dërguar z. Petrit Rama Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave organizative, për shpërblim dëmi, administrative dhe disiplinore.

Në masat organizative, midis të tjerave është rekomanduar dhe kërkuar që *Këshilli i Metrologjisë*:

- të zhvillojë aktivitetin e tij si organ këshillimor në përputhje të plotë me legjislacionin mbi metrologjinë, duke u përqendruar në përafrimin legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.
- të nxjerrë përgjegjësitë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, për shkaqe të pa arsyeshme, pasi për këtë shkak institucioni detyrohet të ekzekutojë 29 vendime gjyqësore duke paguar shumën 30,597.1 mijë lekë.
- *Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Sektorët e Shërbimeve nr. 1, 2, 3 dhe 4*:
 - të sigurojnë listat e subjekteve të reja, të cilat të jenë të rakorduara me Drejtoritë Tatimore Rajonale (DTR), si dhe të planifikojë kontrole të përbashkëta me DTR për zbatimin e legjislacionit të metrologjisë dhe atij fiskal.
 - të krijojë data-baza me të dhënat e subjekteve, duke implementuar programet “Baza e të dhënave të instrumentave matëse”, “Procedurat e matjeve” dhe “Sistemi i Menaxhimit të Adresave”;
 - të hartohen Planet vjetore mbi realizimin e të ardhurave dhe një grafik periodik për verifikimin, kontrollin apo marketimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara;
 - të bëjë analizat periodike 3-mujore, mbi realizimin e të ardhurave nga Sektorët e Shërbimeve, duke nxjerrë mangësitë e konstatuara dhe masat që duhet të marrë.
 - të vërë në funksionim të plotë të gjithë laboratorët specifikë për mjetet matëse pas një kontrolli final mbi kushtet e tyre si dhe të marrë masa urgjente për akreditimin e laboratorëve ekzistues.
 - të përmirësojë rregulloren mbi mënyrën e lëvizjes së automjeteve dhe administrimin e karburantit, bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
 - të përmirësojë regjistrin e vendimeve për gjobat, duke shtuar të dhënat që lidhen me aktet të kontrollit: procesverbalin e mbajtur, vlerën e gjobës identifikimin e inspektorit që ka mbajtur procesverbalin, ecurinë e gjobës fazën ku mbetet vjelja e detyrimit.
 - të krijohet sistemi i kontrollit të brendshëm për tarifat e aplikuara nga metrologët e autorizuar për rregullshmërinë e dokumentacionit, duke implemetuar programin “Procedurat e matjeve”;
 - të merren masa urgjente për verifikimin fillestar të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 2.1. të Rregullores “Për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara”;
 - të rishikohen dhe të plotësohen autorizimet e lëshuara të cilat nuk janë në përputhje me kriteret dhe/ose janë në kundërshtim me nenin 42, të ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, duke marrë masa për rregullshmërinë e akteve me qëllim mos shkaktimin e pagesave të panevojshme etj.

Masat për shpërblim dëmi përfshijnë kërkimin në rrugë ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 10,193,802 lekë, përfituar padrejtësisht nga bashkimi i operatorëve ekonomik “██████████”, si rezultat i mosdorëzimit në afat të mallrave, si dhe për shërbime kontraktuale të pa kryera.

Referuar shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo procedurë, bazuar në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, i është kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, **duke rekomanduar marrjen e masave administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë ose masë disiplinore për punonjësit** :- FT, MH, FTH, AB, KSH, TL dhe GV, për arsye se: nuk kanë marrë kërkesat nga Drejtoritë dhe sektorët brenda DPM; nuk kanë hartuar procesverbalin mbi mënyrën e llogaritjes së fondit limit; nuk ka shkresë zyrtare drejtuar operatoreve ekonomik; si dhe përcaktimi i fondit limit, nuk është kryer në përputhje me metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike.

b. **si dhe me gjobë në vlerën 50,000 lekë ose mase disiplinore** për punonjësit: OSH, AJ, dhe IK, për arsye se, nuk kanë përfshirë në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, për vitin 2011 një procedurë prokurimi.

Bazuar në pikën 8.1, germa “c” nenin 8 “masa disiplinore” të kontratës individuale të punës, është kërkuar **fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore: “Zgjidhje kontratës së punës”**, për: - z. FTH, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML) dhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të vlerësimit të aplikimit të personit juridike për kryerjen e veprimtarive metrologjike, për arsye se: nuk ka realizuar misionin e mbrojtjes së qytetarëve nga matjet e pasakta; nuk ka realizuar programin e verifikimeve të instrumenteve matës; nuk ka hartuar një data-baze për subjektet që i nënshtrohen ligjit për metrologjinë; nuk ka bërë kontrole vlerësuese pas dhënies së autorizimit personit juridik e fizik; proceduat e ndjekura për dhënie autorizimi personit juridik “**[REDAKTUAR]**” nuk janë në përputhje me urdhrin e Ministrit të METE etj.

- VB, LQ, PB dhe JK, për arsye se: nuk kanë realizuar programin e verifikimeve të instrumenteve matës; nuk janë implementuar programet përkatëse të matjeve etj.

Gjithashtu, bazuar në pikën 8.1, germat “b”, “c”, dhe “ç” të nenit 8 “Masa disiplinore” të kontratës individuale të punës, Drejtori i DPM-së, **të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit, për shkeljet e konstatuar dhe të përmendura në këtë raport, rast pas rasti për marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje e kontratës së punës”**, për:

IXH, HT, JK, AM, KD, EB, EM, DD dhe KC, për arsye se, kanë vlerësuar shkelje administrative raste flagrante të përdorimit të instrumenteve dhe matës të pasaktë, të cilat japin sasi karburanti me vlerë jashtë kufijve ligjore, në kundërshtim me ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”; si dhe për punonjësit EL dhe OSH për arsye se, shfuqizimet e vendimeve të gjobave të marra nga inspektori metrolog, janë bërë në kundërshtim me rregulloren përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së, pasi të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në pikën 8.1, germat “b”, “c”, dhe “ç” të nenit 8 “Masa disiplinore” të kontratës individuale të punës, për shkeljet e konstatuar dhe të përmendura në këtë raport, **të analizojë rast pas rasti dhe të marrë masat disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për punonjësit me detyrë metrolog i autorizuar dhe inspektor metrolog, për arsye se nuk kanë realizuar objektivat e planifikuara në planet e punës së miratuara nga Titullari i Institucionit në vitet 2011, 2012 dhe 6- mujorin e parë 2013.**

Bazuar në nenet 248 dhe 143 të Kodit Penal për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe mashtrimit për 23 subjekte, për përdorim të instrumenteve matës të pasaktë që jepen sasi karburanti me vlerë poshtë tolerancës ligjore është propozuar të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim që të çmohet sipas rastit fillimi kryesisht i ndjekjes penale për personat përgjegjës: IXH, HT, JK, AM, KD, EB, EM, DD dhe KC për arsye se, janë konstatuar përdorim të instrumenteve matës, të cilët nuk sigurojnë saktësinë e duhur në matje në dhjetë subjekte.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Me shkresën nr. 704/14 datë 09.01.2014, subjekti i audituar është angazhuar në zbatimin e të gjitha rekomandimeve të KLSH. Gjithashtu, edhe APP me shkresën nr. 704/17, datë 29.01.2014 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë marrjen e të gjitha masave administrative sipas rekomandimeve të KLSH.

Shënim: Auditimi u krye nga zj. Mimoza Lloji përgjegjëse e grupit, z. Shefki Jaupi dhe zj. Lavdije Fshazi. Më tej u shqyrtua nga z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, Drejtori i Departamentit z. Xhafer Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT